


E ARDHMJA E MBROJTJES CIVILE NË VERI TË KOSOVËS



Belgrade Centre for Security Policy



Kosovar Center for Security Studies

E ardhmja e Mbrojtjes Civile në Veri të Kosovës

Beograd dhe Prishtinë
2015

Botuar nga:

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë
Djure Jaksica, 6
11000 Beograd
Telefon dhe faks: +381 11 328 7226; 328 7334
Email: office@bezbednost.org
Ueb: www.bezbednost.org
dhe

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
Sylejman Vokshi, Blloku B, Hyrja 2
10000 Prishtinë
Telefon dhe faks: +381 38 221 420
Email: info@qkss.org
Ueb: www.qkss.org

Autore:

Isidora Stakić dhe Maja Bjeloš
[Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë]

ISBN 978-86-6237-060-0

Redaktor:

Florian Qehaja
[Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë]

Asistente e hulumtimit:

Sofije Kryeziu
[Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë]

Dizajni dhe faqosja:

Marko Marinković

Beograd dhe Prishtinë, 2015
E drejta e autorit © 2015 QBPS dhe QKSS

Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në baza të dhënash, apo të transmetohet në ndonjë formë përmes sistemeve elektronike, mekanike, fotokopjimit, incizimit apo në ndonjë mënyrë tjetër pa lejen paraprake të botuesve.

CIP - Каталогизација у публикацији - Народна библиотека Србије, Београд

355.58(497.115)
351.86(497.115)

STAKIĆ, Isidora, 1983-
E ardhmja e Mbrojtjes Civile në Veri të Kosovës / [autore Isidora Stakić, Maja Bjeloš]. - Beograd : Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë ; Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2015 (Beograd : Unigraf). - 26 str. ; 30 cm

Izv. stv. nasl.: Budućnost Civilne zaštite na severu Kosova. - Tiraž 300. -
Lista e shkurtesave: str. 6. - Aneksi 1: str. 24-25. - Për autorët: str. 26. - Napomene i bibliografske reference uz tekst. - Bibliografija: str. 22-24.

ISBN 978-86-6237-060-0

1. Bjeloš, Maja, 1984- [аутор]
а) Цивилна заштита - Косово б) Косово - Систем безбедности
COBISS.SR-ID 215675404

Ky botim u realizua në kuadër të projektit "Forumi Hulumtues për Siguri: Beograd-Prishtinë-Tiranë", i mbështetur nga qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë. Hulumtimi u përkrah nga Trustit Ballkanik për Demokraci i Programit për Shkëmbim të Punës Profesionale për Nxitje të Politikave të Dialogut, me mbështetje të Zyrës së Jashtme dhe të Komonvelthit të Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet dhe analizat e paraqitura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk i përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e qeverisë së Norvegjisë dhe të Mbretërisë së Bashkuar, apo të ndonjë organizate tjetër që ka të bëjë me to.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
REKOMANDIME	7
HYRJE	8
KRAHASIM I POZITËS JURIDIKE TË MC-SË NË SERBI DHE KOSOVË.	10
NJËSITË E MBROJTJES CIVILE NË VERI TË KOSOVËS	11
PERCEPTIME KUNDËRTHËNËSE PËR MBROJTJEN CIVILE	14
MARRËVESHJA PËR INTEGRIMIN E MC-SË NË INSTITUCIONET E KOSOVËS	16
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	20
BIBLIOGRAFIA	21
ANEKSI 1. INTERVISTAT	24



LISTA E SHKURTESAVE

APPK	Agjencia për promovimin e punësimit në Kosovë
MC	Mbrojtja Civile
AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
KFOR	Forca e NATO-s në Kosovë
PK	Policia e Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë e Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
RKB	Radiologjik, kimik dhe biologjik
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UXO	Mjet i pashpërthyer

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo analizë të pavarur e paraqet gjendjen aktuale të njësive të Mbrojtjes Civile (MC) në katër komuna, të cilat e përbëjnë veriun e Kosovës, dhe sugjerohen zgjidhje të mundshme për të ardhmen e tyre. Ky projekt është realizuar prej dy grupeve të ekspertëve: Qendrës së Beogradit për Politika të Sigurisë dhe Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë në Prishtinë.¹ Njësitë e Mbrojtjes civile veprojnë jashtë kuadrit ligjor të Kosovës përkundër faktit se marrëveshja e Brukselit e parasheh shpërbërjen e të gjitha strukturave paralele serbe të sigurisë që ekzistojnë në Kosovë. Përderisa komuniteti serbë në veri të Kosovës e sheh MC-në si strukturë civile me qëllim të ofrimit të ndihmës për civilë në rast të emergjencave, qeveria e Kosovës, si dhe institucionet ndërkombëtare, të cilat veprojnë në Kosovë, e shohin MC-në si strukturë e jashtëligjshme dhe parashtarake, e cila duhet të shpërbëhet.

Gjatë punës në terren, e cila u bë në shkurt dhe mars të vitit 2015, autorët zbuluan se njësitë e MC-së i kanë 751 punonjës, mes të cilëve ka persona që nuk kanë përvojë në fushën e sigurisë, gjë që është e domosdoshme për kryerjen e detyrave të mbrojtjes dhe shpëtimit, ndërsa një pjesë e personelit janë ish oficerë ushtarakë. Edhe pse mandati zyrtar i njësive të MC-së në veri të Kosovës është që ta ndihmojnë popullatën civile në situata emergjente, këto njësi shpesh kanë kryer edhe detyra të tjera, si mirëmbajtje të rrugëve, riparime të urave, sigurim të ndërtesave, etj. Ndaras prej njësive të MC-së, ekziston vetëm një njësi e zjarrfikësve në veri të Kosovës, e cila vepron si pjesë e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (AME), dhe përbëhet prej rreth 30 zjarrfikësve. Ka indikacione se pjesëtarë individualë të njësive të MC-së janë përfshirë herë pas here në protesta politike, si dhe ka dyshime se disa prej tyre janë përfshirë në ushtrim të dhunës politike dhe krim

të organizuar. Sipas marrëveshjes për Mbrojtjen Civile të arritur më 26 mars 2015 gjatë dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit, të ndërmjetësuar nga BE-ja, njësitë e MC-së në veri të Kosovës mbështeten dhe financohen aktualisht prej qeverisë së Serbisë. Me planin e qeverisë së Kosovës për integrimin e MC-së parashihet që njësitë e saj do të integrohen në institucionet e nivelit qendror të Kosovës, dhe se personeli i tyre do të shpërndahen nëpër disa organe dhe agjenci qeveritare. Megjithatë, marrëveshja po ashtu nënkupton se 218 punonjës të MC-së do të mbesin pa punë dhe pa të ardhura. Një varg çështjesh duhet të kihet parasysh sa i përket planit të integrit, duke përfshirë pamundësinë e institucioneve të Kosovës për t'i absorbuar të gjitha njësitë e MC-së, mos vullnetin e punonjësve të MC-së që të bëhen pjesë e strukturave të Kosovës, si dhe nevojës për të ofruar burime alternative të të ardhurave për ata që do të mbesin pa punë. Përkundër faktit që plani zyrtar për integrimin e njësive të MC-së në veri të Kosovës është bërë tashmë publik,² ende mbetet i panjohur për publikun e gjerë dhe personelin e MC-së, që mund të paraqet probleme shtesë gjatë zbatimit të tij.

REKOMANDIME

Rekomandime të përgjithshme:

- Me qëllim që të rritet transparenca e procesit, të dy qeveritë duhet t'ju ofrojnë qytetarëve informata të sakta dhe objektive lidhur me fazat specifike të procesit të zbatimit.
- Me qëllim që të ketë integrim substancial dhe të mirëfilltë të njësive të MC-së në sistemin e institucioneve të Kosovës, të dy qeveritë duhet të përmbahen prej retorikës nxitëse dhe nacionaliste.

¹ Emrat e qyteteve dhe të komunave janë shkruar në pajtim me Udhëzuesin e Qeverisë së Kosovës për Zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve [gjendet në: http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/Udhezues_Eng_web.pdf].

² Marrëveshja për Mbrojtjen Civile gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Agreement_on_CP_-_initialed_by_Kosovo_260315.pdf

Rekomandime për Serbinë:

- Qeveria e Serbisë duhet ta ndalë financimin dhe mbështetjen për njësitë e MC-së sipas nenit 19 të marrëveshjes së arritur më 26 mars 2015.
- Qeveria e Serbisë duhet t'i bëjë ndryshimet ligjore që të mundësojë shpërbërjen e strukturave të MC-së, dhe të miratojë rregullore të veçanta të qeverisë për pensionimin e personelit të MC-së, i cili nuk duhet të jetë diskriminues sa i përket kufizimit të lirisë së lëvizjes, trashëgimisë së pensionit apo të kritereve të tjera të pensionimit (si mosha, vjetët në shërbim, etj.).
- Qeveria e Serbisë, si dhe komunat në veri të Kosovës, duhet të bashkëpunojnë në hetimet e veprimtarive kriminale të pjesëtarëve të MC-së që akuzohen për krime. Persekutimi i kriminelëve është në interes si të komunitetit serbë ashtu edhe atij shqiptarë.

Rekomandime për Kosovën:

- Para integritit të njësive të MC-së, duhet të bëhet një vlerësim i hollësishëm i profilit të personelit të MC-së, duke përfshirë shkollimin dhe shkathësitë e tyre, si dhe duhet të ofrohen, sipas nevojës, trajnime shtesë.
- Meqë buxheti aktual i Kosovës nuk e mbulon koston e integritit të MC-së dhe të një angazhimi më të madh të AME në veri të Kosovës, qeveria duhet ta bëjë një rishikim të buxhetit dhe të ofron financim të duhur për njësitë e reagimit emergjentë, përtej fondit aktual që është në dispozicion (fondi i kontingjencës dhe ai për zhvillim).
- Njësitë e AME-s në veri të Kosovës (njësitë për zjarrfikës dhe për shpëtim) duhet të forcohen dukshëm meqë një njësi që përbëhet prej afro 30 punonjësve nuk është e mjaftueshme për t'i mbuluar operacionet e MC-së në tërë veriun e Kosovës.
- Pjesa më e madhe e personelit të MC-së duhet të integrohet në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent. Secila prej katër

komunave duhet ta krijon një organ për menaxhimin emergjent ose në nivel të departamentit ose të sektorit, dhe secili duhet ta ketë njësinë për zjarrfikës.

- Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me katër komunat në veri të Kosovës, duhet ta zhvillojë një plan të ri-punësimit, i cili do ta lehtëson transicionin në jetën civile të atyre zyrtarëve policorë dhe punonjësve të MC-së që nuk janë integruar. Është me rëndësi që të sigurohemi që personeli i MC-së, i cili nuk përfiton nga punësimi në institucionet publike, të ketë alternativa të tjera në sektorin privat me qëllim që ata të punësohen mirëfilli dhe të kenë të ardhura të rregullta. Në këtë kontekst, ofrimi i trajnimeve dhe huave nga Qeveria e Kosovës për hapjen e bizneseve të reja, në bashkëpunim me sektorin afarist dhe veçanërisht me donatorët ndërkom-bëtarë, do të jetë tejet relevant për ata që nuk janë integruar në institucionet e Kosovës.

HYRJE

Roli aktual dhe i ardhshëm i njësive të Mbrojtjes Civile (MC) në katër komunat e veriut të Kosovës është temë e shumë kundërthënies për shkak të ndjeshmërisë së lartë të gjendjes politike në veri të Kosovës, si dhe për shkak të mungesës së transparencës në procesin e normalizimit mes Prishtinës dhe Beogradit. Përderisa serbët e Kosovës që jetojnë në jug të lumit Ibër janë integruar gradualisht në strukturat e Kosovës, katër komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe (Mitrovica veriore, Zveçani, Leposaviçi dhe Zubin Potoku) deri vonë kanë mbetur të ndara politikisht dhe ligjërisht prej pjesës tjetër të Kosovës. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja mes Beogradit dhe Prishtinës, i cili nisi në mars të vitit 2011, është përqendruar kryesisht në veri të Kosovës, dhe ka synuar të gjejë modalitete për integrimin e kësaj pjese në strukturat e Kosovës.

Marrëveshja e arritur mes kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë më 19 prill 2013 në Bruksel (Marrëveshja e Brukselit) ka mbetur

e paqartë sa i përket integritit të njësive të MC-së në institucionet e sigurisë së Kosovës. Ndryshe prej referencës që ka sa i përket shpërbërjes së strukturave policore të Ministrisë së Brendshme të Serbisë (neni 7), nuk ka ndonjë referencë të qartë në marrëveshje sa i përket MC-së, megjithëse ajo bënë thirrje për shpërbërjen e të gjitha strukturave paralele të sigurisë në veri të Kosovës. Roli dhe funksioni i MC-së u nënshtrohet interpretimeve dhe shpjegimeve të ndryshme politike në Prishtinë, Mitrovicë veriore dhe Beograd. Mandati i njësive të MC-së është ofrimi i ndihmës për popullatën civile në situata emergjente. Në veri të Kosovës, megjithatë, MC-ja mbetet një prej mekanizmave që ende funksionon jashtë kuadrit ligjor të Kosovës, dhe që nuk janë pjesë apo strukturë e sistemit emergjent civil të Kosovës. Sido që të jetë, pritet që njësitë e MC-së do të transformohen së shpejti dhe do të integrohen gradualisht në institucionet e Kosovës në pajtim me marrëveshjen e arritur më 26 mars 2015, duke e ndjekur shembullin e strukturave të mëparshme të policisë serbe, të cilat u integruan në Policinë e Kosovës (PK).

Së këndejmi, ky punim ka për synim ta bëjë një analizë të statusit ligjor, mandatit dhe strukturës së njësive të KP-së në Serbi, si dhe të zhvillimit të tyre unik në katër komunat e Kosovës në veri që prej vitit 1999. Kjo vihet në kontrast me zhvillimet ligjore dhe institucionale në Kosovë me qëllim që t'i kuptojmë sfidat e mundshme të integritit të njësive të MC-së. Për më tepër, ky hulumtim i analizon perceptimet e ndryshme të shfrytëzimit të MC-së në Beograd, në Mitrovicë veriore dhe në Prishtinë, dhe si mund të kenë ndikuar këto perceptime në zbatimin e marrëveshjes së arritur së voni lidhur me integritimin e personelit të MC-së në institucionet e Kosovës, e po ashtu edhe të rrezikut të mos ofrimit të mundësive alternative të punësimit për personelin e MC-së, i cili nuk do të integrohej në institucionet e Kosovës.

Ky hulumtim, si i tillë, përpiket të ofrojë burime shtesë të informacionit, të përgatitura në mënyrë të paanshme nga dy grupe të pavarura ekspertësh nga Beogradi dhe

Prishtina. Qëllimi ynë në realizimin e këtij hulumtimi është ta plotësojnë mungesën e dokumenteve dhe të literaturës, si dhe të shpjegohet mandati ekzistues i MC-së dhe perspektiva e tij e ardhshme.

Hulumtimi kryesisht bazohet në të dhënat e marra përmes intervistave, të cilat janë mbajtur mes nëntë shkurtit dhe njëzeteshtatë marsit 2015. Hulumtuesit i realizuan 26 intervista kokë më kokë me palët e interesit në Kosovë, duke përfshirë përfaqësues të qeverisë së Kosovës dhe të komunave në veri të Kosovës, një zyrtar të lartë të MC-së dhe personeli i institucioneve dhe i organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, i organizatave të shoqërisë civile dhe i medieve. Në fund të këtij botimi e kemi dhënë listën e të intervistuarve; kurse për shkak të ndjeshmërisë së temës dhe për hir të sigurisë së tyre u është siguruar anonimitet disa të intervistuarve (për zyrtarin e lartë të MC-së dhe gazetarët lokalë). Janë mbledhur dëshmi shtesë përmes kërkesave të dërguara në Ministrinë e Brendshme të Serbisë, dhe në Zyrën për Kosovë dhe Metohi të Qeverisë së Serbisë në pajtim me Ligjin për Lirinë e Informacionit. Përderisa Ministria e Brendshme dha përgjigje të detajuara për të gjitha pyetjet që kishin të bënin me funksionimin e MC-së, në përgjithësi, dhe në veri të Kosovës, në veçanti, më 27 shkurt 2015, Zyra për Kosovë dhe Metohi iu përgjigj vetëm pjesërisht pyetësorit. Për këtë hulumtim janë analizuar dokumente politike dhe juridike, raporte zyrtare të përpiluara nga organizata ndërkombëtare dhe vendore, si dhe artikuj të medieve. Vështirësia më e madhe e kësaj qasje ishte koha e shkurtër për realizimin e punës në terren, që zgjati rreth një muaj, dhe të mos dëshirës së disa personave me interes dhe relevantë për t'u intervistuar lidhur me temën e MC-së [p.sh. përfaqësuesit e ekipit negociues të Prishtinës].

Ky hulumtim u mundësua falë partneritetit të QBPS-së dhe QKSS-së, të cilat mundësuan që të realizohen intervista dhe të mblidhen informata prej palëve të interesit nga Prishtina, Mitrovica veriore dhe Beogradi. Hulumtimi u realizua me përkrahje të Forumit për Hulumtime të Sigurisë Beograd – Prishtinë – Tiranë,

një nismë rajonale trevjeçare, e mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë me qëllim që të nxitet dialogu lidhur me çështjet e sigurisë mes akademikeve, shoqërisë civile dhe medias sa i përket marrëdhënieve shqiptaro-serbe. Puna në terren u realizua në fund të shkurtit dhe në gjysmën e parë të marsit 2015, si pjesë e Trustit Ballkanik për Demokraci i Programit për Shkëmbim të Punës Profesionale për Nxitje të Politikave të Dialogut. Ky program u përkrah nga Zyra e Punëve të Jashtme dhe Komonvelthit e Mbretërisë së Bashkuar.

KRAHASIM I POZITËS JURIDIKE TË MC-SË NË SERBI DHE KOSOVË

Sipas sistemit juridik të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, funksioni i MC-së ishte pjesë e të ashtuquajturës “mbrojtja dhe vetëmbrojtja e përgjithshme popullore”, doktrinë e ushtarake dhe e mbrojtjes e ish Jugosllavisë, e cila bazohej në konceptet e armatës popullore dhe vetëqeverisëse socialiste. Kjo ia mundësoi secilës komunë dhe entitet të ketë personel të specializuar, përgjegjës për mbrojtje individuale dhe të bashkësisë, si dhe të shpëtimit në rast të fatkeqësive apo emergjencave (Wall et al., 2008: 7). Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, ky sistem u braktis, dhe deri në vitin 2009 MC-ja kishte rregullim të dobët, nën një juridiksion konkurrues dhe të ndarë mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme (Milosavljević, 2010: 11). Me miratimin e Ligjit për Situata Emergjente të 29 dhjetorit 2009, funksionimi i MC-së kaloi nën juridiksionin e Ministrisë së Brendshme, e cila kontribuoi në demilitarizimin e MC-së.

Sipas ligjit serb të vitit 2009 për situata emergjente, njësitë themelore operative për mbrojtje dhe shpëtim janë njësitë e MC-së. Ato ndahen në dy kategori të ndryshme: njësitë e përgjithshme dhe njësitë e specializuara (Ligji për Situata Emergjente, 2009: neni 98). Ligji thotë që njësitë e përgjithshme themelohen prej autoriteteve lokale, ndërmarrjeve dhe personave të tjerë juridik si formacione të përkohshme të përbëra prej

vullnetarëve, qytetarëve dhe punëtorëve me qëllim që të realizojnë detyra të thjeshta që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe shpëtimin (Ibid.: neni 99). Njësitë e specializuara, në anën tjetër, themelohen në nivel kombëtar dhe të rretheve nga Sektori për Menaxhimin e Emergjencave i Ministrisë së Brendshme, ose prej ndërmarrjeve dhe personave të tjerë juridik që përbëjnë burim potencial të kërcënimit për territorin më të gjerë sipas Vlerësimit të Rrezikut (Ibid.: neni 99). Njësitë e specializuara të MC-së përbëhen prej dy llojesh të personelit: punonjës me orar të rregullt dhe rezervistë aktivë (Mol, 2013)³ dhe përfshinë njësinë e zjarrfikësve, njësitë për shpëtim nga përmytjet dhe uji, njësitë për shpëtim në terrene të vështira, njësitë e ndihmës së parë, njësitë për zbulimin dhe shkatërrimin e mjeteve shpërthyes (UXO), njësitë për mbrojtje kundër elementeve radiologjike, kimike dhe biologjike, njësitë për mbrojtje dhe shpëtim nga germadhat, njësitë e vëzhgimit, njësitë e alarmimit, njësitë e telekomunikimit dhe njësitë për kujdes dhe strehim (Ligji për Situata Emergjente, 2009, neni 102).

Në sistemin juridik të Kosovës, mbrojtja civile është e ndarë prej mbrojtjes dhe shpëtimit. Përderisa e para është përgjegjësi e FSK-së (më parë e njohur si Trupat Mbrojtëse të Kosovës), kjo e fundit është nën Agjencinë e Menaxhimit Emergjent (AME), e cila vepron si pjesë e Ministrisë së Brendshme. Në këtë sistem, menaxhimi emergjent është kryesisht përgjegjësi e AME-s, dhe në mënyrë të veçantë e njërive për zjarr-fikje dhe shpëtim që vepron në nivel lokal, por nuk janë strukturë e drejtpërdrejtë e AME-s. Ka indikacione që sistemi i zjarrfikësve dhe i shpëtimit i Kosovës do të decentralizohet së shpejti përmes ndryshimit të Ligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim, i cili do t'i vendos njësitë e zjarrfikësve dhe të shpëtimit nën kontrollin e drejtpërdrejtë të komunave (Fushtica, 24 shkurt 2015; Demiri, 25 shkurt 2015). FSK-ja është vija e dytë e reagimit në situata emergjente

³ Sipas udhëzimit administrativ të vitit 2013 për Shërbimin e Rezervistëve Aktivë të Njësive të Specializuara të Mbrojtjes Civile, numri i rezervistëve aktivë nuk duhet ta kalojë 25 për qindëshin e numrit të përgjithshëm të zyrtarëve të specializuar të mbrojtjes civile.

– reagon kur ka emergjenca të shkallës së gjerë ose kur thirret prej autoriteteve lokale për ofrimin e ndihmës [Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, 2008: neni 10]. Duke i krahasuar sistemet e mbrojtjes dhe të shpëtimit të Serbisë dhe Kosovës, mund të vërehet se AME-ja është homologe me Sektorin për Menaxhimin e Emergjencave të Serbisë, ndërsa njësitë për zjarr-fikje dhe shpëtim përkojnë në aspektin konceptues me njësitë e specializuara të MC-së së Serbisë. Për më tepër, ushtria serbe dhe FSK-ja të dyja kanë përgjegjësi dytësore në situata emergjente.

NJËSITË E MBROJTJES CIVILE NË VERI TË KOSOVËS

Sipas një zyrtari të lartë të MC-së, të intervistuar më 5 mars 2015, njësitë e MC-së në komunat në veri të Kosovës u krijuan në formën që kanë tani më 1 maj 2006, gjatë qeverisë së kryeministrit serb Vojislav Koshtunica. Këto njësi u krijuan pa konsultim me Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), e cila ishte pala kryesore qeverisëse në Kosovë në pajtim me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Njësitë u themeluan prej dhe nën drejtimin e katër komunave në veri të Kosovës. Në atë kohë, MC-ja në Serbi rregullohej me ligjin e vitit 1994 për mbrojtje. Ky ligj theksonte që njësitë e MC-së mund të formoheshin prej institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe personave të tjerë juridikë, dhe nuk bëhej ndonjë dallim mes njësive të specializuara dhe të përgjithshme. Për më tepër, Ligji i vitit 2002 i Serbisë për Vetëqeverisje Lokale, i cili ishte në fuqi në atë kohë, i bënte komunat përgjegjëse për organizimin e mbrojtjes ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, dhe për themelimin e organeve dhe shërbimeve sipas nevojave të tyre. Megjithatë, ligji i vitit 2009 për situata emergjente e bartte MC-në nën juridiksionin e Ministrisë së Brendshme dhe ia linte në dorë Sektorit për Menaxhimin e Emergjencave të Ministrisë së Brendshme, përgjegjëse për formimin dhe mbikëqyrjen e njësive të specializuara, ndërsa komunave iu dha mandati për formimin e njësive të përgjithshme. Kara-

teristikat e njësive të MC-së në komunat në veri të Kosovës përkojnë me ato të njësive të specializuara – ato kanë punonjës me orar të plotë, të cilët organizohen, pajisen dhe trajnohen për të realizuar detyra komplekse në lidhje me mbrojtjen dhe shpëtimin. Përgjigjet e Ministrisë së Brendshme të Serbisë ndaj pyetësorit të QBPS-s [27 shkurt 2015] theksojnë se njësitë e MC-së në Mitrovicën veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok nuk janë nën direktivën e Ministrisë së Brendshme të Serbisë, në kontradiktë me dispozitat e Ligjit për Situata Emergjente të Serbisë për njësitë e specializuara. Sipas përfaqësuesve politikë të komunave në veri të Kosovës, këto njësi të MC-së mbeten në kuadër të përgjegjësisë komunale [Janković, 4 mars 2015; Hodžić, 4 mars 2015; Vulović, 12 mars 2015].

Madhësia dhe anëtarësimi

Pas themelimit në vitin 2006, njësitë e MC-së në veri të Kosovës i kishin rreth 500 punonjës me orar të rregullt, shumica e të cilëve kishin përvojë ushtarake dhe ishin të trajnuar për të kryer detyra të mbrojtjes dhe të shpëtimit [zyrtari i lartë i MC-së, 2015]. Deri më tani, numri i tyre është rritur në 751, pasi janë punësuar punëtorë të ri në tri raste – në vitin 2008, 2013 dhe 2014 [Ibid]. Sipas zyrtarëve në Mitrovicën veriore dhe zyrtarëve të lartë të MC-së atje, personeli i MC-së i punësuar që prej vitit 2008 nuk ka kaluar nëpër trajnimet elementare ushtarake, e as nuk janë trajnuar për kryerjen e detyrave të mbrojtjes dhe të shpëtimit. Shumë prej të intervistuarve u shprehën se disa prej tyre janë punësuar falë përkatësisë së tyre partiake-politike dhe jashtë procedurave normale [Dimitrijević, 19 shkurt 2015; Nešović, 4 mars 2015; Krstić, 5 mars 2015]. Sipas një zyrtari të lartë të MC-së [5 mars 2015], një numër i rekrutëve e kishin ndjekur më vonë trajnim për zjarr-fikje dhe shpëtim për terrene malore në Beograd, por që nuk ishin pajisur me certifikata zyrtare.

Është me rëndësi të themi se ka njësi të MC-së edhe jashtë veriut të Kosovës, të shpërndarë gjeografikisht nëpër disa komuna në jug të lumit Ibër. Megjithatë, personeli i këtyre një-

sive nuk u diskutua në negociatat në Bruksel, dhe si rrjedhojë nuk do të përfshihen në procesin e integritimit. Sipas vlerësimit të zyrtarit të MC-së janë rreth 210 punonjës të MC-së në jug të lbrit, me vendndodhje në Štrpce/Shtërpce, Kosovën qendrore (p.sh. Lipjan/Lipljan, Gračanica/Gračanica etj.), Kamenicë/Kamenica, Shillovë/Šilovo dhe Gjilan/Gnjilane.⁴

Disa prej të intervistuarve theksuan se ish pjesëtarët e grupit të “Rojave të urës” janë të punësuar aktualisht në njësitë e MC-së (Bjelica, 2015; Dimitrijević, 2015; Bimbashi, 2015). Grupi i “Rojave të urës” u formua pas luftës në Kosovë, dhe përbëhej prej të rinjve që e konsideronin grupin si strukturë e sigurisë me tri funksione: për t’i parandaluar shqiptarët që të hynin në veri të Mitrovicës, të mblidhnin informata nga KFOR-i dhe UNMIK-u, dhe të mblidhnin informata prej shqiptarëve që jetojnë në veri të Mitrovicës (OSBE, 2003: 12). Si rezultat i kapaciteteve të kufizuara të UNMIK-ut për ta marrë në duar sundimin e ligjit në veri të Kosovës, “Rojat e urës” i kryen edhe disa funksione të policisë (p.sh. arrestimi i njerëzve) krahas policisë së Serbisë (Ibid.). Megjithatë, më vonë ata u perceptuan si të përfshirë edhe në veprimtari kriminale si zhvatje, kërcënime të banorëve lokalë, të cilët bashkëpunonin me UNMIK-un, kontrabandë, prostitucion, etj. (ICG, 2002: 3). Sipas raportit të OSBE-s, deri në vitin 2003 “Rojat e urës” financoheshin prej Ministrisë së Shëndetësisë së Serbisë përmes buxhetit për spitalin në veri të Mitrovicës, pas së cilës datë duket se financimi nga qeveria e Serbisë është ndaluar; ndërsa raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave (ICG) thekson se “Rojat e urës” po financoheshin nga Ministria e Brendshme dhe Shërbimi i Sigurimit i Serbisë, duke e shkelur kështu rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Duhet të bëhen hulumtime të mëtejme për ta verifikuar vërtetësinë e pretendimeve që njësitë e MC-së i kanë rekrutuar në radhët e veta “Rojat e urës”, që nënkupton se organizata vazhdon të ekzistonte por me emër tjetër (dhe me anëtarësim të ri), meqë ka pretendime

kundërthënëse nga të intervistuar të tjerë të cilët pohojnë se MC-ja nuk ishte pasardhëse e “Rojave të urës”, d.m.th. nuk ka ndonjë vazhdimësi midis dy organizatave.

Mandati dhe veprimtaria

Njësitë e MC-së kanë mandat që të ofrojnë ndihmë për popullatën civile në komunat në veri të Kosovës në rast të fatkeqësive natyrore dhe situatave të tjera emergjente. Sipas përfaqësuesve politikë të komunave veriore, njësitë e MC-së janë të angazhuara vazhdimisht në aktivitete të vëzhgimit dhe të paralajmërimit, të fikjes së zjarreve, të operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit, të pastrimit të borës gjatë dimrit, si dhe në aktivitete të tjera që janë pjesë e konceptit të punës së MC-së. Gjatë vërshimeve në Serbi dhe Bosnje në maj të vitit 2014, personeli i MC-së nga veriu i Kosovës mori pjesë në operacionet e mbrojtjes dhe të shpëtimit në disa vende në Serbi (p.sh. Shabac dhe Obrenovac). Sipas Stevan Pavićević, një prej koordinatorëve të MC-së nga veriu i Kosovës, ata u ftuan nga kryeministri i Serbisë Aleksandar Vučić, Sektori për Situata Emergjente i Ministrisë së Brendshme dhe Zyra për Kosovë dhe Metohi e qeverisë (Tanjug, 16 maj 2014). Jashtë situatave emergjente, njësitë e MC-së nganjëherë kryejnë shërbime për komunitetin, të cilat rëndom nuk janë përgjegjësi e MC-së, si mirëmbajtja e rrugëve, pastrimi i shtratit të lumit Ibër, riparimet e urave, sigurimi i ndërtesave, etj. (Hodžić, 4 mars 2015; Janković, 4 mars 2015; Vulović, 12 mars 2015). Veçmas prej njësisë të MC-së, ekziston vetëm një njësi e zjarrfikësve në veri të Kosovës, e cila vepron si pjesë e AME-s, dhe përbëhet prej afro 30 zjarrfikësve (Hodžić, 4 mars 2015; Janković, 4 mars 2015). Sipas zyrtarëve prej komunave veriore, MC-ja bashkëpunon me këtë njësi në rast të situatave emergjente, si të zjarreve. Ka një dublimi të mandatit juridik të njësisë të MC-së të themeluar në vitin 2006 dhe të njësisë së zjarrfikësve dhe shpëtimit, e cili është pjesë e strukturave të Kosovës, edhe pse më parë e theksuam se njësitë e MC-së nganjëherë angazhohen në detyra të cilat nuk janë në mandatin e tyre juridik. Megjithatë, duke e pasur

4 Modeli i OSBE-së i gjuhës së përdorur në Kosovë.

parasysh madhësinë e katër komunave në veri të Kosovës, me një hapësirë gjeografike prej 1200 km², njësia e zjarrfikësve të AME-s nuk mjafton që të ofron mbrojtje të duhur për popullatën civile. Për shembull, sipas vlerësimeve të komunave veriore, kanë ndodhur rreth 300 zjarre në veri të Kosovës në vitin 2014 [Janković, 4 mars 2015]. Andaj, njësitë e MC-së ofrojnë shërbime publike, të cilat nuk ofrohen aktualisht prej institucioneve qendrore të Kosovës.

Megjithëkëtë, ka indikacione që njësitë e MC-së nuk janë të përfshirë vetëm në detyra civile, por edhe në kryerjen e shërbimeve alternative të sigurisë, dhe si rrjedhojë janë faktor politik në veri të Kosovës, dhe bartin me vete një simbolikë të theksuar. Në vitin 2011, pas përpjekjes së njësive speciale të Policisë së Kosovës (ROSU) që t'i marrin nën kontroll pikë kalimet kufitare, personeli i MC-së u përfshi në vendosjen e bllokadave në rrugë dhe mori pjesë në përlëshjet e dhunshme me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in [Bimbashi, 27 shkurt 2015; shih po ashtu: Akter, 2013]. Ata shihen prej autoriteteve të Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare si ushtarë në terren të protestave politike në veri dhe kryes të dhunës politike, jo vetëm kundër kundërshtarëve politikë, por edhe kundër shqiptarëve të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare. Një prej të intervistuarve po ashtu pretendoi se personeli i MC-së është i lidhur me krimin e organizuar dhe është i përfshirë në veprimtari kriminale, si kontrabandë [Bimbashi, 27 shkurt 2015], dhe se ka dëshmi kundër tyre në Zyrën e Prokurorit të Kosovës [Dimitrijević, 11 shkurt 2015; Bimbashi, 27 shkurt 2015]. Përkundër spekulimeve të shumta, deri më tani nuk kemi ndonjë të hetuar nga ana e punonjësve të MC-së. Sipas intervistës me Fisnik Rexhepin [10 mars 2015], me integrimin e ish-zyrtarëve të policisë së Serbisë në Policinë e Kosovës në pajtim me marrëveshjen e Brukselit, MC-ja i mori përsipër edhe disa funksione policore në komunat veriore (p.sh. patrullimin), diçka që është e papranueshme për autoritetet kosovare. Këto janë dyshime që MC-ja është e përfshirë në veprimtari të inteligjencës.

Financimi dhe pajisjet

Njësitë e MC-së në katër komunat në veri të Kosovës financohen aktualisht prej qeverisë së Serbisë nga buxheti për komuna [Janković, 4 mars 2015; Hodžić, 4 mars 2015; Vulović, 12 mars 2015]. Andaj, edhe kontrollohen dhe i raportojnë autoriteteve komunale, dhe si rrjedhojë tërthorazi edhe qeverisë së Serbisë, edhe pse Ministria e Brendshme e Serbisë dhe Zyra për Kosovë në mënyrë zyrtare e mohojnë se i kontrollojnë njësitë e MC-së në veri të Kosovës.⁵ Njësitë e MC-së janë të pajisura me pajisje të shpëtimit, duke përfshirë barka të shpëtimit, pajisje për vëzhgim dhe paralajmërim, radio transmetues, etj. [zyrtari i lartë i MC-së, 2015]. Sipas disa të intervistuarve nga komunat veriore, pajisjet e njësive të MC-së janë përforcuar dukshëm dhe se është rritur prania e tyre gjatë mandatit të Aleksandar Vulinit si drejtor i Zyrës për Kosovën. Mes pajisjeve me të cilat janë pajisur ish-in edhe uniformat që e mbanin shenjën e mbrojtjes civile ndërkombëtare dhe tri automjete “Lada Niva” për terrene malore për secilën komunë [12 sosh gjithsej]. Posterë promovues për njësitë e MC-së u vendosën në veri të Mitrovicës. Meqë shpenzimet e qeverisë së Serbisë nuk janë transparente është e vështirë që të shihet se si transferohen mjetet nga qeveria qendrore në nivelin lokal. Andaj, është e paqartë se sa mjete financiare i kanë pranuar këto katër komuna nga Serbia për pajisjen e njësive të MC-së, për ta rritur praninë e tyre dhe për pagat e punonjësve.

Një prej aspekteve më kundërthënëse të njësive të MC-së në veri të Kosovës lidhet me akuzat se ato ishin formacione të armatosura. Sipas intervistës sonë me Fisnik Rexhepin [10 mars 2015], zyrtarë të qeverisë së Kosovës pretendojnë se ia kanë paraqitur ndërmjetësuesve të BE-së në Bruksel dëshmitë që njësitë e MC-së janë të armatosura dhe të pajisura si formacion paraushtarak, dhe si rrjedhojë paraqesin kërcënim për sig-

⁵ Përgjigje zyrtare nga Zyra për Kosovë e qeverisë së Serbisë në pyetësinë e QBSP-së, 23 shkurt 2015, dhe përgjigja zyrtare nga Ministria e Brendshme e Serbisë në pyetësinë e QBSP-së, 27 shkurt 2015.

urinë, dhe kërcënim të rendit kushtetues të Kosovës [Rexhepi, 10 mars 2015]. Zyrtarët e Kosovës pretendojnë se i kanë paraqitur ndërmjetësuesve të BE-së në dialogun e Brukselit dëshmi të bollshme që tregojnë karakterin paraushtarak të njësive të MC-së [Ibid.]. Megjithatë, Serbët nga veriu i Kosovës e mohojnë se njësitë e MC-së janë të armatosura ose kanë strukturë organizative ushtarake. Sipas marrëveshjes për integrimin e MC-së, e nënshkruar më 26 mars 2015, qeveria e Serbisë ka ofruar konfirmim me shkrim se MC-ja dhe personeli i tij nuk kanë posedim të armëve [neni 12]. Hulumtimet e mëparshme për armët e lehta në Kosovë kanë treguar se shumë qytetarë të Kosovës janë në posedim të armëve të paligjshme [Khakee dhe Florquin, 2003: 11; UNDP Kosovo, 2011: 1], dhe nuk është për t'u habitur nëse disa prej punonjësve të MC-së kanë në posedim armë të tilla. Sipas medieve në Kosovë, zyrtari serb Krstimir Pantiq kishte deklaruar se njësitë e MC-së duhet të armatosen dhe të përgatiten për ta mbrojtur popullatën serbe në veri të Kosovës [Telegrafi, 14 shkurt 2013]. Sido që të jetë, nuk ka dëshmi që njësitë e MC-së, si të tilla, janë trajnuar apo pajisur si formacion ushtarak. Sipas zyrtarëve të qeverisë së Kosovës, çështja më e rëndësishme dhe më urgjente është shpërbërja e njësive të MC-së dhe integrimi i tyre në strukturat e Kosovës [Rexhepi, 10 mars 2015]. Çështja e armëve të paligjshme është një problem më i madh sesa çështja e MC-së, dhe do të trajtohet gjatë vjetëve në vijim.⁶ Andaj, pjesa e marrëveshjes për integrimin e MC-së thekson se, nëse qeveria e Kosovës mund të ofrojë dëshmi të besueshme që njësitë e MC-së kanë në posedim armë zyrtare, ato do ta informojnë lehtësuesin e BE-së, dhe EULEX-in si dhe Policinë e Kosovës që të realizojnë një operacion të përbashkët të kërkimit pa njoftim paraprak [neni 18].

⁶ Sipas zyrtarëve të qeverisë së Kosovës, është duke u hartuar *ligji për dorëzimin vullnetarë të armëve të paligjshme*.

PERCEPTIME KUNDËRTHËNËSE PËR MBROJTJEN CIVILE

Mbrojtja civile ka qenë problem politik midis Beogradit dhe Prishtinës me vjet të tëra, por prej arritjes së *Marrëveshjes së parë të përmirësimit që e rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve* [më tutje: Marrëveshja e Brukselit] mes kryeministrit të Serbisë dhe të Kosovës më 19 prill 2013, u bë obligim juridik, pasi të dy palët janë të përkushtuara që ta zbatojnë në praktikë atë për të cilën janë pajtuar.

Për shkak të paqartësisë së tekstit të Marrëveshjes së Brukselit, neni 8 i së cilës e parasheh shpërbërjen e të gjitha strukturave paralele të sigurisë në veri të Kosovës, pa i specifikuar njësitë e MC-së, autoritetet në Beograd dhe Prishtinë po përpiqen t'i plotësojnë zbrazëtitrat në marrëveshje dhe ta realizojnë zbatimin e saj. Paqartësia lë hapësirë për kreativitet dhe konsensus, por shpesh shpie në interpretime të ndryshme, keqkuptime dhe vështirësi në arritjen e pajtimin për çështje të caktuara. Megjithatë, marrëveshja për MC-në mes Beogradit dhe Prishtinës u nënshkrua më 26 mars 2015. Marrëveshja u botua në faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, por që përmbajtja e saj në kohën deri sa të del në shtyp ka mbetur e panjohur për publikun e gjerë.

Për momentin, dhe duke i pasur parasysh interpretimet dhe diskursin politik të ndryshëm sa i përket mandatit dhe qëllimit të MC-së mes Prishtinës, veriu të Mitrovicës dhe Beogradit, ekzistojnë vizione të ndryshme nëse dhe si do të integrohen njësitë e MC-së në institucionet e Kosovës.

MC-ja shihet nga qeveria e Kosovës si një strukturë e paligjshme paralele e sigurisë, 'krahu i zgjatur i Beogradit në Kosovë', një formacion paraushtarak, një OJQ, pasues i të ashtuquajturve 'Roja të urës', etj. Duke e ndjekur shembullin e integritit të policisë, shumica e të intervistuarve u pajtuan se është vetëm çështje e kohës derisa të shpërbëhen njësitë e MC-së dhe personeli i tyre të integrohet në institucionet e Kosovës. Megjithatë, nuk mund të flasim për shpërbër-

jen e MC-së dhe të personelit të saj, por për një transformim të organizimit dhe të mandatit të tyre [Nikola, 26 shkurt 2015]. Në këtë drejtim, është tërhequr një paralele me transformimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në FSK, meqë një numër i madh i personelit të TMK-së u integrua në FSK, e cila vazhdoi të kryente detyra për mbrojtjen e popullatës civile. Kosova ka aplikuar presion për zbatimin e marrëveshjes në mënyrë që ajo të përshpejtohet dhe që strukturat e MC-së të mbylleshin, duke këmbëngulur që qeveria e Serbisë të ndërmer masa juridike për shpërbërjen e strukturave të MC-së në Kosovë, dhe t'ia paraqes BE-s dëshmitë zyrtare për ndaljen e mbështetjes financiare dhe të pagave për MC-në, dhe të miratimit të rregulloreve të nevojshme për zbatimin e tyre [raporti i qeverisë së Kosovës, 2015: 12].

Për disa përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare nuk është problem vet mbrojtja civile, por mandati dhe organizimi i tij aktual. Andaj, MC-ja duhet të shpërbëhet, të rirregullohet, të riorganizohet dhe të orientohet ekskluzivisht për kryerjen e detyrave civile. BE-ja e mbështet shpërbërjen e MC-së, por se përshtypja është se shpesh e mban rolin e lehtësuesit dhe se i shmanget përgjegjësisë për zbatimin e marrëveshjeve. Po ashtu, shihet se BE-ja nuk është shumë e interesuar në zgjidhjen e sfidave të zbatimit në terren për aq sa për çdo gjë të arrihet pajtimi 'në letër'. Për më tepër, KFOR-i i ka të gjitha informatat e nevojshme për situatën në terren, por nuk e sheh MC-në si kërcënim të sigurisë.⁷

Disa prej të intervistuarve serbë nga veriu i Mitrovicës e theksuan themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe (AKS) si prioritet më të lartë sesa MC-ja, dhe se kjo çështje duhet të zgjidhet në nivel politik. Të intervistuarit serbë theksuan vazhdimisht se AKS-ja mund të shërbejë si kornizë institucionale për integrimin e njësive të MC-së. Megjithatë, përfaqësuesit e komunitetit shqiptarë dhe disa përfaqësues serbë nga veriu i Kosovës nuk janë të mendimit që AKS-ja duhet të

paraqet një kornizë institucionale për integrimin e njësive të MC-së. Kjo nuk është e mundur sidomos kur marrëveshja për integrimin e MC-së është arritur para themelimit të AKS-së. Sido që të jetë, Prishtina kërkon që çështja e MC-së të zgjidhet para se të themelohet AKS-ja, sepse duket se për AKS-në mund të nevojiten ndryshime kushtetuese, dhe si rrjedhojë është një problem më i komplikuar juridik dhe politik sesa MC-ja, përderisa në anën tjetër, Beogradi këmbëngulë për një proces krejtësisht të kundërt lidhur me këtë.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile në Kosovë, posaçërisht në veri, e kanë përshtypje se të gjitha marrëveshjet që vijnë si rezultat i dialogut të Brukselit e paraqesin vetëm vizionin e elitës, d.m.th., të dy kryeministrave dhe të ndërmjetësuesit të BE-së, ndërsa shoqëria civile nga dy komunitetet është lënë anash. 'Çdo gjë që po ndodh ose që duhet të ndodh në veri do të ndodh së pari në Bruksel ose Beograd dhe Prishtinë. Shoqëria civile, për fat të keq, e ka humbur legjitimitetin për t'i përfaqësuar interesat e bashkësisë serbe dhe të marrë vendime për të ardhmen e tyre. Vendimmarrja për të ardhmen e MC-së i është lënë Beogradit' [Nikola, 26 shkurt 2015]. Rikthimi i marrëdhënieve të qëndrueshme mes Kosovës dhe Serbisë është bërë më i vështirë pas dështimit të dialogut të nivelit të lartë të dy vendeve për t'ju ofruar mundësi shoqërisë civile dhe komuniteteve që ta ngrenë zërin dhe shqetësimet e tyre [Saferworld, 2015]. Komunikimi i dobët dhe mungesa e transparencës nga palët negociuese kanë shpënë në interpretime dhe pritje të ndryshme të ndikimit që ka Marrëveshja e Brukselit, si dhe e kanë rritur mosbesimin dhe tensionet midis njerëzve [ibid]. Sipas gazetarit të intervistuar të veriut të Mitrovicës për këtë hulumtim, 'politikanët në Beograd kanë hequr dorë prej komunitetit serb në Kosovë, por nuk e kanë kurajën ta thonë këtë, dhe se qytetarëve të veriut të Kosovës u jepet ky informacion pjesë-pjesë. Integrimi i policisë është dëshmi se gjithçka është arritur, edhe pse zyrtarët policorë e kundërshtojnë fillimisht integrimin. Njerëzit e ndërrojnë mendjen, posaçërisht kur janë nën presion, u bëhet shantazh ose nëse u jepen para'. Duke e pasur këtë parasysh,

7 Përgjigja zyrtare nga KFOR-i ndaj pyetësorit të QBPS, 18 mars 2015.

ekziston përshtypja se do të shuhet e gjithë rezistenca ndaj integritimit. Për më tepër, gjatë hulumtimit të tyre në veri të Kosovës, autorët e këtij raporti vërejtën se njerëzit nuk kanë dëshirë të flasin për këtë dhe për tema të tjera meqë kanë frikë.

Udhëheqësit politikë në veri të Kosovës theksojnë se Mbrojtja Civile ka një imazh negativ, të cilin e mori që në themelim, por është një ekzagjerim të pretendohet se është një organizatë paraushtarake. MC-ja ka reputacion të keq për shkak të disa abuzimeve në të kaluarën, si nga politikanët ashtu edhe nga strukturat kriminale. Gjersa qëllimi fillestar i MC-së ishte mbrojtja e qytetarëve të veriut të Kosovës prej dhunës së mundshme të ekstremistëve shqiptarë, tani funksioni i tyre kryesor ka të bëjë me mbrojtjen e njerëzve dhe pronave. Mendimi i udhëheqësve politikë lokalë serbë është që secili prej punonjësve të MC-së që është kriminel duhet të persekutohet, por për këtë nuk duhet t'i vuajë pasojat negative të shpërbërjes së MC-së as tërë personeli i MC-së e as e tërë popullata e veriut të Kosovës [Hodžić, 4 mars 2015].

Sipas politikanëve në veri të Kosovës, ky problem, si shumë të tjerë, hynë në domenin e politikave të nivelit të lartë, dhe se nuk merren parasysh mendimet e tyre as nga qeveria e Serbisë e as nga ajo e Kosovës. Së këndejmi, është me rëndësi të dëgjohet zëri dhe shqetësimet e tyre. Përfaqësuesit e komunave serbe dëshirojnë që MC-ja të mbetet nën juridiksionin e tyre, me mandatin si e kanë tani – që të shërbejë si organizatë për mbrojtje dhe shpëtim gjatë fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera civile. Sipas tyre, njësitë e MC-së nuk kanë numër të madh të punonjësve duke e pasur parasysh vëllimin e punëve që bien në kuadër të mandatit të tyre në katër komunat në veri të Kosovës. Përfaqësuesit e komunave serbe pretendojnë se njësia e zjarfikësve dhe e shpëtimit, e cila vepron në veri të Mitrovicës, dhe i raporton AME-s nuk mjafton për ofrimin e mbrojtjes civile, e cila për momentin duket se është një vlerësim i saktë duke e marrë parasysh madhësinë aktuale të njësisë. Për më tepër, zyrtarët komunalë këmbëngulin se është i nevojshëm special-

izimi i personelit të MC-së, si dhe i trajnimeve shtesë për profile të ndryshme, si shoferë, shpëtimtarë për terrene malore, etj. Vizioni i njësisë të MC-së nën juridiksionin e komunës mbetet një çështje problematike, pasi sipas ligjeve si të Serbisë dhe të Kosovës, njësitë e përhershme [të specializuara] për reagim të shpejtë në raste emergjente i raportojnë institucioneve qendrore, në veçanti Sektorit të Situatave Emergjente të Ministrisë së Brendshme të Serbisë dhe Agjencisë për Menaxhimin Emergjent të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Edhe pse sipas ligjit të Kosovës për vetëqeverisje lokale, komunat e Kosovës janë përgjegjëse për emergjencat lokale, ligji nuk e parasheh në mënyrë të qartë se atyre iu lejohet të formojnë njësi të përhershme të MC-së. Për më tepër, Ligji për zjarfikje dhe shpëtim [neni 4] thekson se komunat janë përgjegjëse vetëm për themelimin dhe menaxhimin e njësisë vullnetare të shpëtimit. Andaj, personeli i njësisë të MC-së – me mandatin dhe përgjegjësitë aktuale – nuk do të mund të mbes nën kompetencat e komunave.


MARRËVESHJA PËR INTEGRIMIN E MC-SË NË INSTITUCIONET E KOSOVËS

Marrëveshja për integrimin e njësisë të MC-së në institucionet e Kosovës u arrit më 26 mars 2015, në kuadër të kornizës së dialogut të Brukselit. Marrëveshja gjendet në ueb-sajtin e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, por në kohën e shkrimit të këtij dokumenti ajo nuk njihet në publikun e gjerë. Marrëveshja bazohet në planin e qeverisë së Kosovës dhe i rendit detyrimet specifike si të Prishtinës ashtu edhe të Beogradit. Prishtina ka premtuar që t'i krijon 483 vende pune brenda institucioneve të Kosovës për personelin e MC-së, dhe 50 pozita që do të paguhen nga fondi i kontingjencës, ndërsa Beogradi e ka për detyrim ta shuajë financimin e njësisë të MC-së në veri të Kosovës. Procedura e integritimit do të bazohet në parimet e njëjta si integrimi i ish zyrtarëve policorë të Serbisë në Policinë e Kosovës. Beogradi e ka dorëzuar listën e 751 pjesëtarëve të MC-së që do të integrohen

në institucionet e Kosovës [neni 1]. Një panel prej katër anëtarëve (me dy përfaqësues të institucioneve të Kosovës, një përfaqësues të ish Mbrojtjes Civile dhe një përfaqësues i BE-s) do të themelohet më 27 prill 2015, i cili do t'i zgjedh kandidatët për pozitat e caktuara në pajtim me shkollimin dhe përvojën e tyre profesionale [neni 5]. Vetëm ata pjesëtarë të MC-së që kanë letërnjoftim të vlefshëm të Kosovës do të mund të integrohen [neni 3], ndërsa verifikimi i sigurisë për personelin e MC-së do të kryhet nga Policia e Kosovës dhe EULEX-i [neni 13]. Marrëveshja thekson se

zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit [2015: 13]. Plani premtonte 550 pozita gjithsej, prej të cilave 400 persona do të integroheshin në institucione të ndryshme civile të Kosovës, ndërsa 50 do të vendoseshin në listën e pritjes që do të integroheshin gradualisht brenda tri vjetëve gjersa do të paguheshin nga fondi i kontingjencës.⁸ Deri në 100 persona do të punësoheshin përmes projekteve të financuara nga Fondi për Zhvillim⁹ [ibid]. Procedurat për integrim ishin në pajtim me Ligjin e Kosovës për Shërbimin Civil. Në anën tjetër, marrëveshja e MC-së thekson se qe-

Diagrami 1



paneli do ta kryejë punën e vet më 14 gusht 2015, dhe të gjitha kontratat e punësimit do të nënshkruhen me 1 shtator 2015 [neni 7]. Marrëveshja po ashtu thekson heqjen e pikave vrojtuese të MC-së dhe dorëzimi i të gjitha objekteve dhe pajisjeve të tyre, të cilat do të vazhdojnë të shfrytëzohen prej institucioneve të Kosovës [neni 12 - 18].

Numri i vendeve të punës që ofrohet nga qeveria e Kosovës për ish-pjesëtarët e MC-së, sipas marrëveshjes së MC-së të arritur në mars të vitit 2015, është më i vogël sesa ai që ishte premtuar në raportin e qeverisë së Kosovës dorëzuar BE-së për progresin e

veria e Kosovës po i ofron 483 pozita në veri të Kosovës, ndërsa do të jenë edhe 50 pozita që do të paguheshin prej fondit të kontingjencës, që nënkupton se këta individë do të marrin rrogë, porse vendi i tyre i punës në sektorin publik do të përcaktohet brenda tri vjetëve [neni 1]. Prej këtyre 483 pozitave në veri të

⁸ Do të krijohet fondi i kontingjencës për qëllim të integritetit të njësive të MC-së në institucionet e Kosovës. Plani është që të grumbullohen 10 milionë euro për tre vjet.

⁹ Fondi për zhvillim u krijua më 17 janar 2014 sipas marrëveshjes për mbledhjen e taksave doganore. Financohet përmes taksave që mbledhen në pikat kufitare të Jarinjës dhe Bërnjakut. Mjetet në dispozicion të fondit janë 5 milionë euro.

Kosovës, vetëm 125 janë specifikuar në marrëveshje – 80 në AME, 25 në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe 20 pozita që kanë të bëjnë me trashëgiminë religjioze dhe kulturore. Ky formulim lë pa përgjigje në pyetjen se cilat institucione të Kosovës do t'i akomodojnë 358 pjesëtarët e tjerë të MC-së. Duke e pasur parasysh procedurën për zgjedhjen e punonjësve potencialë prej personelit aktual të MC-së (neni 2-10), ky numër mund të rritet pasi personeli i MC-së mund të mos i plotësojë kushtet për të cilat janë marrë vesh palët. Nëse marrëveshja e MC-së zbatohet në tërësi, 218 pjesëtarë aktualë të MC-së do të mbesin pa punë dhe pa të ardhura.

Janë pasqyruar dy elemente themelore të planit të qeverisë së Kosovës në Marrëveshjen e MC-së. E para është që njësitë e MC-së do të integrohen në institucionet e nivelit qendror të Kosovës, ndërsa e dyta është që personeli i tyre do të shpërndahet në një varg organesh dhe agjencish qeveritare. Sipas përfaqësuesve të qeverisë së Kosovës, integrimi i personelit të strukturave paralele të Serbisë në institucionet qendrore është me rëndësi themelore për integrimin e tërë komunitetit serb në shoqërinë e Kosovës – duke pasur përfaqësues në nivelin qendror, serbët e Kosovës do ta kenë më të lehtë t'i pranojnë si të vetat institucionet e qeverisë së Kosovës. Sipas zyrtarëve të Kosovës, nëse njësitë e MC-së mbeten nën juridiksionin ekskluziv të komunave, do të thellohet ndarja dhe se do të rritet mundësia për konflikt në të ardhmen. Integrimi i personelit të MC-së në FSK është një mundësi tjetër për qeverinë e Kosovës, por qeveria e Serbisë dhe udhëheqësit lokalë nuk donin ta pranonin këtë ide. Megjithatë, ka indikacione se veçse është arritur një marrëveshje për integrimin e MC-së në FSK (Sadiku, 27 mars 2015). Është me rëndësi të vërejmë se plani i qeverisë së Kosovës thekson se personeli i njësive të MC-së do të mbetet fizikisht në komunat e tyre, por do të administrohet prej institucioneve qendrore. Meqë njësitë e MC-së në veri të Kosovës shihen nga Prishtina si organizata paraushtarake dhe si rrezik për sigurinë, është më rëndësi për qeverinë e Kosovës që ato të mos integrohen si njësi, por të shpërndahen nëpër institucione

të ndryshme [Ibid]. Kjo do ta eliminonte fuqinë simbolike që e paraqet MC-ja – prania e strukturave të sigurisë së Serbisë në territorin e Kosovës. Megjithëkëtë, plani i qeverisë së Kosovës mund të has në disa sfida.

Pensionimi dhe/ose ri-punësimi

Meqë as qeveria e Serbisë e as ajo e Kosovës nuk i njoftuan ata të cilët ndikohen drejtpërdrejtë për vizionin dhe planet e tyre të ardhme sa i përket integritet të MC-së, punëtorët e MC-së i kanë zhvilluar interpretimet dhe thashethemet e veta që bazohen në frikë dhe mungesë të informacionit. Personeli i MC-së e sheh se plani i qeverisë së Kosovës, si raportohet në medie, nuk ofron punësim të përhershëm dhe të përshtatshëm për personelin e MC-së, por vetëm një zgjidhje të përkohshme kalimtare. Kjo është në kundërshtim me deklaratën e Edita Tahirit në medie se secili do të ketë një vend pune, dhe i gjithë personeli i strukturave paralele në veri të Kosovës do të integrohet në institucionet e Kosovës. Personeli i MC-së shqetësohet se integrimi i MC-së në sistemin juridik dhe institucional të Kosovës është vetëm i përkohshëm, dhe se do të dëbohen herët a vonë prej tij. Për shembull, është e mundur që disa punonjës të MC-së që do t'i bashkoheshin Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) do të dështonin më vonë t'i plotësonin disa prej kriterëve [si moshja] dhe standardet profesionale, posa të bëhen kontrollet fizike dhe psikologjike. Kjo do të shpinte në pensionimin e tyre, lënien e tyre edhe njëherë jashtë institucioneve, dhe me një pension minimal. Në këtë mënyrë, të dy qeveritë do të dalin me duar të lara prej tyre. Ky shqetësim buron pjesërisht prej përvojës së integritet të zyrtarëve policorë serbë, të cilët ishin në listën e rrogave të Ministrisë së Brendshme të Serbisë, në Policinë e Kosovës, në të cilin disa prej punonjësve të Ministrisë së Brendshme të Serbisë që kishin aplikuar nuk i përmbushën kriteret, dhe disa të tjerë që nuk e kaluan verifikimin e sigurisë mbetën jashtë sistemit [Bjeloš dhe Elek, 2014: 5]. Për shkak të kësaj, kërkohen garanci që një pjesë e MC-së të integrohet në FSK, ndërsa të themelohet një

program i demobilizimit që ofron punë të denja dhe të besueshme alternative për ata që nuk i plotësojnë kriteret e rekrutimit.

Nëse disa prej punonjësve të MC-së lihen jashtë sistemit, do të dalin probleme të reja, si rritja e mundësisë për trazira sociale dhe politike në veriun e Kosovës. Së dyti, integrimi i MC-së në strukturat e Kosovës do të kërkon rishikim të buxhetit të Kosovës, pasi buxheti aktual nuk parasheh buxhet për këtë transformim. Një problem tjetër që mund të del është refuzimi i personelit të MC-së për t'u integruar në institucionet qendrore të Kosovës për shkak të pozitës zyrtare të palës serbe sa i përket shtetësisë së Kosovës. Në fund, dhe mbase më e rëndësishmja, është themelore që të gjendet punësim aktivë për personelin e MC-së në institucionet e Kosovës. Nëse kemi të bëjmë vetëm me paga, atëherë ajo do ta zgjidh dimensionin socio-ekonomik të problemit, por jo dimensionin politik. Meqë punonjësit e MC-së do të mbesin fizikisht në komunat veriore, dhe nëse nuk u ofrohet punë e vërtetë, ata do jenë në gjendje të funksionojnë edhe më tej si struktura paralele të sigurisë.

Andaj, procesi i shpërbërjes së njësive të MC-së dhe integrimi i tyre në institucionet e Kosovës duhet të përcillet me një plan shtesë të pensionimit dhe/ose me një program të ri-punësimit. Deri më tani, nuk ka ndonjë indikacion që qeveria e Kosovës ose e Serbisë të kenë zhvilluar ndonjë program të tillë. Meqë marrëveshja për MC-në nuk ofron punësim për të gjithë 751 punonjësit e njësive të MC-së në veri të Kosovës, programi duhet të zbatohet nga katër komunat ose autoritetet e Kosovës me përkrahje të bashkësisë ndërkombëtare që të ofrojë ri-punësim në të ardhmen për personelin e MC-së që do të mbetet jashtë institucioneve qendrore të Kosovës.

Vlerësimet aktuale vënë në dukje se janë 88 punonjës të MC-së në veri të Kosovës që duhet të dalin në pension, si dhe rreth 115 të cilët nuk i përmbushin kriteret juridike për integrim për shkak të faktit se nuk kanë nënshpëtësi të Kosovës [Raporti i qeverisë së

Kosovës, 2015: 13]. Duhet ta kemi parasysh se MC-ja vepron edhe në jug të lumit Ibër, dhe më shumë se 200 punonjës të MC-së janë duke marrë aktualisht rroga për kryerjen e detyrave të MC-së. Ka gjasa që këta individë ta kenë fatin e njëjtë më ish punonjësit e Ministrisë së Brendshme meqë marrëveshja e Brukselit ka të bëjë në mënyrë ekskluzive me veriun e Kosovës, duke e lënë jashtë gjithkënd tjetër nga procesi i integritimit. Është me rëndësi që të sigurohemi që këtyre punonjësve të MC-së t'u ofrohet mbështetje që të kenë punësim të mirëfilltë dhe të ardhura të rregullta, me të cilat do të mund ta mbanin vetën dhe familjen.

Sipas raportit të qeverisë së Kosovës [2015: 12-13], qeveria e Serbisë ka premtuar se do t'i ndërmerr masat juridike për shpërbërjen e strukturave të MC-së në Kosovë, ngjashëm si ka bërë në rastin e integritimit të policisë. Nëse qeveria e Serbisë propozon një *lex specialis* apo e miraton një rregullore të veçantë qeveritare për pensionimin e personelit të MC-së, ajo nuk duhet të jetë diskriminuese sa i përket kufizimit të lirisë së lëvizjes, trashëgimit të pensionit ose të kriterëve të tjera të pensionimit [si mosha, vitet në shërbim, etj.].

Një program i ri-punësimit për ata punonjës të MC-së, të cilët nuk do të përfitojnë prej punësimit në institucionet publike, duhet të ofron alternativa të tjera në sektorin privat, ngjashëm me programin e zhvilluar për demobilizimin e ish pjesëtarëve të Trupave Mbrotjëse të Kosovës [TMK]¹⁰ apo të Forcave Ushtarake të Serbisë.¹¹ Kjo mund të kontribuojë në zbatimin e suksesshëm të marrëveshjes Prishtinë-Beograd për MC-në. Megjithatë, qeveria e Kosovës nuk ka aktualisht buxhet për integrimin e MC-së, dhe si rrjedhojë programi i ri-punësimit nuk është paraparë për vitin 2015. Ky lloj programi duhet të mbështetet përmes donacioneve

10 Ky projekt u zbatua nga UNDP-ja në Kosovë mes vitit 2009 dhe 2011. Rreth 1,300 ish punonjës të TMK-së u përfshinë në këtë program të ri-punësimit.

11 Programi PRISMA gjendet në: https://www.bicc.de/uploads/tx_bicctools/brief31_serbian.pdf
http://www.mod.gov.rs/sadrzaj.php?id_sadrzaja=6291
<http://www.kombeg.org.rs/aktivnosti/komora/Komora.aspx?veza=1324>

nga bashkësia ndërkombëtare, dhe të hartohet në partneritet me katër komunat në veri të Kosovës dhe me autoritetet e Prishtinës. Një marrëveshje mes palëve do të mund t'i inkurajonte donatorët që të bashkëpunojnë me qeverinë e Kosovës dhe me personelin e MC-së në veri të Kosovës që ta zhvillojnë dhe ta funksionalizojnë një projekt që ka për qëllim ri-integrimin e personelit të MC-së, i cili nuk do të integrohej në institucionet e Kosovës.

Para zbatimit të një projekti të tillë duhet të realizohet një vlerësim i përbërjes aktuale të MC-së sa i përket numrave dhe shkathtësive që kanë. Kjo do të shërbente si bazë për zhvillimin e programit dhe të parashikimeve buxhetore. Përmes shfrytëzimit të praktikave më të mira prej programit të ri-integrimit të TMK-së do të mund të aplikoheshin dy gjëra në këtë rast. E para, një pagesë si shpërblim që do të paguhej për çdo muaj do t'ua siguronte këtyre pjesëtarëve një siguri ekonomike dhe do t'u ndihmonte që të kalonin më lehtë në jetën civile. Së dyti, do të mund të ofroheshin një varg shërbimesh të veçanta nga Agjencia për Promovimin e Punësimit të Kosovës (APPK), ekspertiza e personelit të së cilës në punësim dhe në sektorin e trajnimeve profesionale do ta ndihmonte personelin e MC-së që t'i rriste aftësitë e veta për punësim, si dhe do t'i mbështeste që të kërkonin mënyra alternative të jetesës. Në këtë kontekst, trajnimet dhe huat për zhvillimin e bizneseve të vogla do të ishin tejet relevante. Personelin i MC-së duhet të mbështetet në hulumtimin e tregut me qëllim që t'i vlerësojnë, verifikojnë dhe zhvillojnë idetë e tyre apo të planeve të biznesit, si dhe të potencialit të tyre komercialë. Për fat të keq, një program i tillë i ri-punësimit nuk është zhvilluar ende për zyrtarët e policisë në jug të lumit Ibër, të cilët u detyruan të dalin në pension në vitin 2013 dhe u lanë pa ndonjë perspektivë të punësimit në sistemin policor as të Serbisë as të Kosovës [Bjeloš dhe Elek, 2014: 12]. Për më tepër, nuk u zhvillua as edhe ndonjë plan që do t'u ndihmonte ta kalonin fazën e tranzicionit prej jetës si zyrtarë policorë në jetën civile.

Ekziston edhe një opsion për integrimin e disa pjesëtarëve të MC-së në strukturat komunale të cilat nuk merren me MC-në. Sipas Ligjit të Kosovës për vetëqeverisje lokale, komunat janë përgjegjëse për një varg shërbimesh, duke përfshirë: planifikimin urban dhe rural; shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin; zbatimin e rregulloreve për ndërtim dhe standardet për kontrollimin e ndërtimeve; mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal; ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike; turizëm, aktivitete kulturore dhe argëtuese, etj. [Rexhepi, 10 mars 2015]. Nëse personeli i MC-së integrohet në strukturat komunale, funksioni i reagimit dhe i shpëtimit në situata emergjente do t'i transferoheshin tërësisht njësisë të zjarr-fikjes dhe të shpëtimit të AME-s. Meqë tani ekziston vetëm një njësi e tillë me 30 punonjës që i mbulojnë të katër komunat veriore, qytetarët e veriut të Kosovës nuk do të kenë mbështetje të mjaftueshme në rast të emergjencave. Një problem tjetër me këtë zgjidhje është se, sipas përfaqësuesve të komunave serbe, personeli i MC-së nuk është i kualifikuar për pozita administrative. Megjithatë, ka pozita nën juridiksionin komunal që nuk janë administrative dhe të cilat mund të ofrojnë punësim për një pjesë të personelit të MC-së.

Shpërbërja e MC-së do të jetë një detyrë e komplikuar, nga aspekti i stabilitetit afatgjatë të Kosovës, por tejet me rëndësi. Për këtë arsye, është me rëndësi të madhe ofrimi i ndihmës gjatë lirisimit të ish-punonjësve të MC-së nga detyra dhe kalimi i tyre në jetën civile. Së këndejmi, programi i ri-punësimit mund të kontribuojë në reduktimin e rrezikut permanent, përfshirë edhe rrezikun ndaj sigurisë, rrezikun social, ekonomik, politikë dhe atij të natyrës praktike.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Mbrojtja Civile në veri të Kosovës ka qenë temë e negociatave politike mes Beogradit dhe Prishtinës që prej vitit 2013, por që marrëveshja është arritur tash së voni për integrimin e këtyre njësive në sistemin juridik dhe institucional të Kosovës. Përkundër kësaj, e ardhmja e njësive të MC-së në komunat veriore të Kosovës është ende e pasigurt, dhe se ka interpretime të ndryshme të modaliteteve të zbatimit të saj. Duke e pasur parasysh se ky proces udhëhiqet nga elita, ashtu si edhe shumë procese të tjera, shpejtësia e zbatimit dhe rezultatet që do të dalin varen kryesisht prej vullnetit politik të qeverisë së Serbisë dhe të Kosovës. Një gjë është e sigurt – të dy palët duhet të bëjnë kompromise dhe ta pranojnë se zgjidhja optimale për problemin e MC-së ka gjasa që të mos jetë një zgjidhje ideale për cilëndo palë të përfshirë. Megjithatë, fakti se zyrtarët policorë serbë janë integruar në PK-në na jep shpresë se çështja e MC-së do të zgjidhet në të njëjtën mënyrë. Megjithëkëtë, dallimet në vijim midis policisë dhe integritit të MC-së duhet të merren parasysh në fazën e hershme të zbatimit marrëveshjes. Përderisa zyrtarët policorë serbë kanë mbetur në të njëjtën punë, ndërsa shumica e personelit të MC-së do të transferohen në pozita që nuk kanë të bëjnë me MC-në, e që kërkon kryerjen e trajnimeve shtesë. Gjatë procesit të shpërbërjes së njësive të MC-së nga veriu i Kosovës dhe ri-integrimi i personelit të tyre, është me rëndësi që të merren parasysh shqetësimet e sigurisë së njerëzve në të katër komunat veriore të Kosovës, si dhe të sigurohen burime të nevojshme – njerëzore, financiare dhe materiale – për funksionimin e mbrojtjes dhe shpëtimit në rast të situatave emergjente. Në fund, duhet të hartohet dhe arrihet pajtim për një program të ri-punësimit, i cili duhet të mbështetet si çështje me prioritet, në mënyrë që të përfitojnë prej tij të gjithë zyrtarët policorë dhe punonjësit e MC-së si në jug ashtu edhe në veri të lumit Ibër që u lanë pa punë pas shpërbërjes së institucioneve të tyre të mëparshme.

BIBLIOGRAFIA

Legjislacioni dhe publikimet qeveritare:

- Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2003, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008, Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Nr. 03/L-46.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2004, Ligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Nr. 04/L-049.
- Qeveria e Republikës së Kosovës, 16 janar 2014, *Gjendja e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit*, raport i dorëzuar në Bashkimin Evropian, gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_implementation_state_of_play_of_the_Brussels_Agreements_160114-signed.pdf
- Qeveria e Republikës së Kosovës, 10 tetor 2014, *Gjendja e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit*, raport i dorëzuar në Bashkimin Evropian, gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_Implementation_of_Brussels_Agreements_101014.pdf
- Qeveria e Republikës së Kosovës, 23 mars 2015, *Gjendja e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit*, raport i dorëzuar në Bashkimin Evropian, gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_Implementation_of_Brussels_Agreements__230315-signed-signed.pdf
- Qeveria e Republikës së Kosovës, 26 mars 2015, *Marrëveshja për Mbrojtjen Civile*, gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Agreement_on_CP_-_initalied_by_Kosovo_260315.pdf
- Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë 2013, Udhëzimi administrativ për shërbimin e rezervistëve aktiv në njësitë e specializuara të Mbrojtjes Civile, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 46/2013.
- Kuvendi Nacional i Republikës së Serbisë 2009, Ligji për Situatat Emergjente,

Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 111/2009.

- Përgjigja zyrtare e Zyrës së Qeverisë së Serbisë për Kosovë dhe Metohi ndaj pyetësorit të QBPS, 23 shkurt 2015.
- Përgjigja zyrtare e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë ndaj pyetësorit të QBPS, 27 shkurt 2015.
- Përgjigja zyrtare e KFOR-it ndaj pyetësorit të QBPS, 18 mars 2015.

Raporte dhe publikime:

- BIRN Kosovo, Internews Kosova and CRTA [2014], *Big Deal Report: Civilised Monotony?*, Gjendet në: <http://www.balkaninsight.com/en/file/show/BIG%20DEAL%20FINAL%20ENG.pdf>
- BIRODI [2015], *Monitoring Report on the implementation of Brussels Agreement*, gjendet në: <http://www.mc.rs/upload/documents/istrazivanje/2015/02-03-15-BIRODI-Istrazivanja-sprovodjenja-Briselskog-sporazuma.pdf>
- Bjeloš, M. dhe Elek, B. [2014], *Police Integration In North Kosovo: Progress And Remaining Challenges In Implementation Of The Brussels Agreement*, Belgrade: BCBP, gjendet në: [http://www.bezbednost.org/upload/document/police_integration_nk_\[web\].pdf](http://www.bezbednost.org/upload/document/police_integration_nk_[web].pdf)
- Development Group [2012], *The Kosovo-Serbia dialogue: Close to the EU, far from the Citizens*, gjendet në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/09785.pdf>
- Emini, Donika [2015], *Kosovo Security Barometer – Special Edition: Public Perceptions on Kosovo's Foreign Policy and Political Dialogue with Serbia*, Prishtina: KCSS, gjendet në: <http://www.qkss.org/en/Reports/Special-Edition-of-KSB-Public-Perceptions-on-Kosovos-Foreign-Policy-and-Political-Dialogue-with-Serbia-333>
- European Commission [2014], *Kosovo Progress Report*, gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

- European Commission [2014], *Serbia Progress Report*, gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20140108-serbia-progress-report_en.pdf
- International Crisis Group [2002], *UNMIK's Kosovo Albatross: Tackling Division in Mitrovica*, Balkans Report No. 131, gjendet në: <http://www.refworld.org/docid/3de7574a5.html>
- International Crisis Group [2009], *Serb integration into Kosovo: Taking the Plunge*, Europe Report No. 200, gjendet në: https://www.cimicweb.org/cmo/ComplexCoverage/Documents/Kosovo/Current%20Documents/200_serb_integration_in_kosovo___taking_the_plunge_2009.pdf
- International Crisis Group [2011], *North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice*, Europe Report No. 211, gjendet në: <https://www.cimicweb.org/cmo/ComplexCoverage/Documents/Kosovo/Current%20Documents/211%20North%20Kosovo%20---%20Dual%20Sovereignty%20in%20Practice.pdf>
- International Crisis Group [2012], *Setting Kosovo Free: Remaining Challenges*, Europe Report No. 218, gjendet në: [http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/218-setting-kosovo-free-remaining-challenges.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/europe/balkans/kosovo/218-setting-kosovo-free-remaining-challenges.pdf)
- International Crisis Group [2013], *Serbia and Kosovo: The Path to Normalisation*, Europe Report No. 223, gjendet në: <http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/223-serbia-and-kosovo-the-path-to-normalisation.pdf>
- Ipsos [2014], Šta misle Srbi na severu Kosova? Mozaik nade, izazova i očekivanja [Public opinion poll on the perception of Serbs from North Kosovo on the Brussels Agreement], gjendet në: <http://www.mc.rs/upload/documents/istrazivanje/2015/02-03-15-IPSOS-Sta-misle-Srbi-na-severu-Kosova.pdf>
- Joseph, R. and Hoogenboom, J. [2014], *North Kosovo in 2020: Future Histories in the Making*, PAX, gjendet në: <http://www.paxforpeace.nl/stay-informed/news/north-kosovo-in-2020-future-histories-in-the-making>
- Khakee, Anna and Florquin, Nicolas [2003], *Kosovo and the Gun: A Baseline Assessment of Small Arms and Light Weapons in Kosovo*, United Nations Development Programme and Small Arms Survey (joint publication), gjendet në: <http://www.seesac.org/sasp2/english/publications/general/kosovo.pdf>
- Milosavljević, B. [2010], “Novo zakonsko uređenje vanrednih situacija i uloga lokalne samouprave” [New Legal Regulation of Emergency Situations and the Role of Local Authorities], *Lokalna samouprava: Propisi i praksa* [Local Self-Government: Regulations and Practices], No. 1.
- OSCE [2003], *Paralelne strukture na Kosovu* [Paralel Structures in Kosovo], gjendet në: <http://www.osce.org/sr/kosovo/42586?download=true>
- Saferworld [2015], *Giving people a voice in the EU-facilitated dialogue between Kosovo and Serbia*, gjendet në: <http://www.saferworld.org.uk/resources/view-resource/882-giving-people-a-voice-in-the-eu-facilitated-dialogue-between-kosovo-and-serbia>
- UNDP Kosovo [2011] *Revised Kosovo Small Arms Control Initiative (KOSSAC)*, gjendet në: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/kossac/signed%20ProdocKOSSAC_2011.pdf
- Wall, E., Chu, E. and Dimitrijević, I. [2008], *The Civil Protection System in Serbia*, Jefferson Institute, gjendet në: http://www.jeffersoninst.org/sites/default/files/Civil%20Protection%20System%20in%20Serbia_0.pdf

Artikuj gazetash:

- Akter 2013, “Policajci idu u penziju, a onda u KPS” [Zyrtarët policorë shkojnë në pension, dhe pastaj në Policinë e Kosovës], *Akter*, 15 dhjetor 2013, gjendet në: <http://akter.co.rs/weekly/34-bezbednost/print-65427-policajci-idu-u-penziju-a-onda-u-kps.html>

- *First Agreement of Principles Governing the Normalization of Relations (Brussels Agreement)*, *Danas*, 19 prill 2013, gjendet në: http://www.danas.rs/danasrs/politika/prevod_sporazuma_koji_je_danas_parafiran_u_briselu.56.html?news_id=259487
- *Implementation Plan*, 22 May 2013, gjendet në: <http://euobserver.com/media/src/0807580ad8281aefa2a89e38c49689f9.pdf>
- Petrović, D. N., “Severu oteta i civilna zaštita” [“Hiqet Mbrojtja Civile nga Veriu”], *Vesti online*, 28 mars 2015, gjendet në: <http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/481495/Severu-oteta-i-civilna-zastita>
- “Postignut sporazum o integraciji pripadnika civilne zaštite sa Severa” [“U arrit marrëveshja për integrimin e personelit të Mbrojtjes Civile”], *Kosovo Sever Portal (KoSSev)*, 26 mars 2015, gjendet në: http://kossev.info/strana/arhiva/postignut_sporazum_o_integraciji_pripadnika_civilne_zastite/4325
- Tanjug 2014, “Stiže pomoć i sa Kosova i Metohije” [Ndhima arrin nga Kosova dhe metohija], *Alo!*, 16 maj 2014, gjendet në: <http://www.alo.rs/vesti/aktuelno/stize-pomoc-i-sa-kosova-i-metohije/55296>
- Telegrafi 2013, “Mbrojtja Civile Serbe rrahu rëndë disa ushtarë të KFOR-it” [KFOR Soldiers Severely Beaten by Serbian Civil Protection], *Telegrafi* 14 shkurt 2013, gjendet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/kosove/mbrojtja-civile-serbe-rrahu-rende-disa-ushtare-te-kfor-it.html>
- Tasić, J., “Edita Tahiri: Srbija mora da prizna Kosovo pre ulaska u EU”, *Danas*, 8 mars 2015, http://www.danas.rs/danasrs/politika/edita_tahiri_srbija_mora_da_prizna_kosovo_pre_ulaska_u_eu.56.html?news_id=298427
- Tasić, J., “Dogovor o gašenju civilne zaštite na severu KiM” [Marrëveshja për shpërbërjen e Mbrojtjes Civile në Kosovën veriore], *Danas*, 28 mars 2015, gjendet në: http://www.danas.rs/danasrs/politika/dogovor_o_gasjenju_srske_civilne_zastite_na_severu_kim.56.html?news_id=299467

- Živković, R., “Integracija Srba u bezbednosne strukture” [Integrim i serbëve në strukturat e sigurisë], *Akter*, 3 nëntor 2013, gjendet në: <http://akter.co.rs/weekly/33-politika/59426-integracija-srba-u-bezbednosne-strukture.html>

ANEKSI 1. INTERVISTAT

- Alush Beqiri, Drejtor i Departamentit për Parandalim, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, në Prishtinë, 25 shkurt 2015
- Gzim Bimbashi, gazetar, RTK, në Prishtinë, 27 shkurt 2015
- Jelena Bjelica, konsulente e pavarur për Big Deal Report [Raportin e Marrëveshjes së Madhe], në Beograd, 9 shkurt 2015
- Miran Demiri, Drejtor i Departamentit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, në Prishtinë, 25 shkurt 2015
- Pavle Dimitrijević, Zyra për hulumtime sociale [BIRODI], në Beograd, 11 shkurt 2015
- Nenad Đurić, ushrues detyre i komandantit rajonal për Kosovën veriore, në Mitrovicë, 4 mars 2015
- Lulzim Fushtica, Këshilltar vendor i CSAT, Programi për siguri të komunitetit, ICITAP, Kosovë, në Prishtinë, 24 shkurt 2015
- Adrijana Hodžić, Shefe e Zyrës Administrative të Mitrovicës, në Mitrovicë, 4 mars 2015
- Valerie Hopkins, BIRN, në Prishtinë, 25 shkurt 2015
- Faik Ispahiu, Internews Kosova, në Prishtinë, 25 shkurt 2015
- Vučina Janković, Kryetar i Zveçanit, në Mitrovicë, 4 mars 2015
- Branislav Krstić, Gazetar i pavarur në Mitrovicë, 5 mars 2015
- Veroljub Matić, MA në siguri, në Mitrovicë, 5 mars 2015
- Shpresa Mulliqi, Misioni i OSBE-s në Kosovë, në Prishtinë, 27 shkurt 2015
- Branislav Nešović, OJQ Aktiv, në Mitrovicë, 4 mars 2015
- Ferdinand Nikola, Saferworld, në Prishtinë, 26 shkurt 2015

- Anton Quni, Deputet i Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në Prishtinë, 24 shkurt 2015
- Fisnik Rexhepi, Këshilltar i lartë politik, Ministria për Integrim Evropian, në Prishtinë, 10 mars 2015
- Valdet Sadiku, Zyrtar ndërlidhës në Beograd, në Beograd, 27 mars 2015
- Damian Sedar, Këshilltar politik për zbatimin e dialogut, Zyra e BE-s në Kosovë/Përfaqësuesi Special i BE-s, në Prishtinë, 2 mars 2015
- Nexhmedin Spahiu, Drejtor i Radio Mitrovicës, në Mitrovicë, 4 mars 2015
- Afërdita Syla, Drejtoreshë ekzekutiv, Community Building Mitrovica, në Mitrovicë, 4 mars 2015
- Stefan Vulović, Kryetar i Zubin Potokut, në Zveçan, 12 mars 2015
- Intervistë me zyrtarin e lartë të MC-së, në Mitrovicë, 5 mars 2015
- Intervista me përfaqësues të KFOR-it, në Prishtinë, 11 mars 2015
- Intervista me gazetarë nga Kosovo Sever Portal [KoSSev.info], në Mitrovicë, 5 mars 2015

PËR AUTO RËT

Maja BJELOŠ është diplomuar në Studime Ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Politike, Universiteti në Beograd, ku edhe ka përfunduar programin Master në Sigurinë Ndërkombëtare. Që nga viti 2009 ajo është angazhuar si hulumtuese në BCSP. Maja ka specializuar në çështje gjinore dhe reformën e sektorit të sigurisë në Serbi, duke publikuar raporte të ndryshme të tilla si politikës e sigurisë në Serbi, Siguria Evropiane dhe sektori i sigurisë në Serbi, si dhe përfaqësimi i pakicave kombëtare në reformën e sektorit të sigurisë në Serbi. Gjithashtu, Maja është bashkë - redaktore në gazetën Aspektet Gjinore dhe Siguria.

Isidora STAKIĆ ka diplomuar në marrëdhëniet ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd, dhe posedon diplomë Masteri në të Drejtat e Njeriut në një program të Erasmus Mundus në bashkëpunim të tri universiteteve nga Britania e Madhe, Suedia dhe Norvegjia. Isidora iu bashkua BCSP në vitin 2012 në pozitën e hulumtuese e re. Interesat e saj hulumtuese përfshijnë: sigurinë rajonale dhe marrëdhëniet ndëretnike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ekstremizmin e krahut të djathtë, të drejtat e minoriteteve, si dhe perspektivën gjinore në siguri.

PËR ORGANIZATAT

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (KCSS) Kosovë

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2008 me qëllim kryesor të zhvillojë studimet kërkimore-shkencore, në sektorin e sigurisë. QKSS zhvillon hulumtime dhe organizon konferenca dhe seminare në fushën e politikave të sigurisë, sundimit të ligjit, drejtësisë, dhe monitorimin e sektorit të sigurisë. Aktivitetet e QKSS-së kontribuojnë në forcimin e parimeve të mbikëqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë në Republikë Kosovës.

QENDRA E BEOGRADIT PËR POLITIKA TË SIGURISË (BCSP) Serbi

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë (BCSP) është një think-tank i pavarur që nga viti 1997 duke avokuar publikisht për sigurinë kombëtare dhe njerëzore të bazuar në demokraci dhe të drejtat e njeriut. BCSP punon në drejtim të konsolidimit të sektorit të sigurisë (RSS) dhe integritit të sigurisë të shteteve të Ballkanit Perëndimor në bashkësinë Euro-atlantike, duke krijuar një mjedis të politikave të sigurisë bazuar në njohuri gjithëpërfshirëse. Te gjitha këto objektiva i arrin nëpërmjet hulumtimit, avokimit publik, arsimimit, si dhe duke sjellë së bashku palët e interesuara për krijimin e kontakteve dhe bashkëpunimeve të ndryshme.

RRETH PROJEKTIT

Forumi Hulumtues i Sigurisë është një projekt i përbashkët në mes të tri qendrave të pavarura hulumtuese nga Beogradi (BCSP), Prishtina (QKSS) dhe Tirana (IDM) të specializuara në hulumtimin e çështjeve të sigurisë. Projekti ka për qëllim të nxisë debat të balancuar midis qendrave hulumtuese (think-tank), komunitetit akademik, politikës publike dhe medias, në mënyrë që të sigurojë zgjidhje alternative për sfidat e vazhdueshme të bashkëpunimit ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe Shqipërisë.

